



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:088776

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06326178

C.nr.1491/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me praktikanten D.O. në çështjen kontestimore të paditësve V.T., M.B., A.M., E.S., A.Ç., nga Prizreni të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë B.K. dhe F.G. avokatë nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimin e pagës me rritje për shkak të inflacionit, jashtë seance, me datë 21.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve V.T., M.B., A.M., E.S., A.Ç., nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit të ia kompensoj paditësve dhe atë:

● Për paditësin V.T.

1. Për periudhën kohore Prill - Dhjetor 2019, në shumën prej 90.93 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 1.20 euro;
3. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.85 euro;

Në shumën e përgjithshme prej 263.98 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (04.05.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Për paditësen M.B.

1. Për periudhën kohore Prill - Dhjetor 2019, në shumën prej 90.93 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 1.20 euro;
3. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.85 euro

Në shumën e përgjithshme prej 263.98 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (04.05.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

- Për paditësen A.M.

1. Për periudhën kohore Prill - Dhjetor 2019, në shumën prej 90.93 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 0.96 euro;
3. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.85 euro

Në shumën e përgjithshme prej 263,74 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (04.05.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

- Për paditësen E.S.

1. Për periudhën kohore Prill - Dhjetor 2019, në shumën prej 90.93 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 0.96 euro;
3. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.85 euro

Në shumën e përgjithshme prej 263.74 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (04.05.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

- Për paditësen A.Ç.

1. Për periudhën kohore Prill - Dhjetor 2019, në shumën prej 90.93 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 0.96 euro;
3. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.85 euro

Në shumën e përgjithshme prej 263.74 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (04.05.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve të ia paguaj shumën prej 342 euro, në afat prej

7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve: V.T. përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 509.43 euro, përkatësisht shuma prej 245.45 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit; M.B. përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 522.06 euro, përkatësisht shuma prej 258.08 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit; A.M. përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 421.59 euro, përkatësisht shuma prej 157.85 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit; E.S. përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 421.59 euro, përkatësisht shuma prej 157.85 euro në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si dhe A.Ç. përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 421.59 euro, përkatësisht shuma prej 157.85 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

### A r s y e t i m

Paditësit V.T., M.B., A.M., E.S., A.Ç., nga Prizreni të cilin sipas autorizimit i përfaqësojnë B.K. dhe F.G., avokatë nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 04.05.2022 kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni - Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësit janë është në marrëdhënie pune në SH.F.M.U "Pjetër Budi" në Prizren, si mësimdhënës, dhe bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore nga muaji prill 2017 deri në muajin dhjetor 2021 dhe atë në shkallë të inflacionit për vitin 2017 në 1.5%, për vitin 2018 në 1.1%, për vitin 2019 në 2.7%, për vitin 2020 në 0.2%, 2021 në 3.4% në pagën e kërkuar për paditësin V.T. në lartësi prej 509.00 euro, në pagën e kërkuar për paditësen M.B. në lartësi prej 521.64 euro, për paditësen A.M. në lartësi prej 421.59 euro, për paditësen E.S. në lartësi prej 421.59 euro, dhe për paditësen A.Ç. në lartësi prej 421.59 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore në lartësi prej 8% në vit, e cila llogaritet nga data 17.04.2017 e deri në pagesën definitive.

E paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 10.02.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me

nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Padiësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë padiëses nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e padiëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e padiëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e padiëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimi me numër të referencës 42/2022 e datës 10.02.2022 për padiësin V.T. e lëshuar nga Drejtori i Shkollës SH.F.M.U "Pjetër Budi" në Prizren, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se padiësi në periudhën kohore prej 10.09.2008 deri me 31.12.2021, ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës dhe nga ky raport kontraktual merr pagën bazë në lartësi prej 421.00 euro. Po ashtu nga vërtetimi me numër të referencës 43/2022 e datës 10.02.2022 për padiësen M.B. e lëshuar nga Drejtori i Shkollës SH.F.M.U "Pjetër Budi" në Prizren, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se padiësi në periudhën kohore prej 01.09.2000 deri me 31.12.2021, ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës dhe nga ky raport kontraktual merr pagën bazë në lartësi prej 421.20 euro. Nga vërtetimi me numër të referencës 44/2022 e datës 10.02.2022 për padiësen A.M. e lëshuar nga Drejtori i Shkollës SH.F.M.U "Pjetër Budi" në Prizren, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se padiësi në periudhën kohore prej 06.10.2021 deri me 31.12.2021, ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, si

mësimdhënës dhe nga ky raport kontraktual merr pagën bazë në lartësi prej 421.20 euro. E po ashtu nga vërtetimi me numër te referencës 45/2022 e datës 10.02.2022 për paditësen E.S. e lëshuar nga Drejtori i Shkollës SH.F.M.U “ Pjetër Budi” në Prizren, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi në periudhën kohore prej 13.12.2021 deri me 31.12.2021, ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse dhe nga ky raport kontraktual merr pagën bazë në lartësi prej 421.20 euro. Si dhe nga vërtetimi me numër te referencës 46/2022 e datës 10.02.2022 për paditësen A.Ç. e lëshuar nga Drejtori i Shkollës SH.F.M.U “Pjetër Budi” në Prizren, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi në periudhën kohore prej 06.10.2021 deri me 31.12.2021, ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës dhe nga ky raport kontraktual merr pagën bazë në lartësi prej 421,20 euro.

Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve V.T., M.B., A.M., E.S., A.Ç., ju takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për paditësin V.T.

Për periudhën 01.04.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2019 ka qenë 421.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 90,93 euro ( $421.20 \times 2.7\% = 11.36 \times 8 \text{ muaj} = 90.93$  euro).

Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 421.20, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 1.20 euro ( $421.20 \times 0.2\% = 0.84 \times 12 \text{ muaj} = 10.10$  euro), mirëpo gjykata në rastin konkret aprovoj vetëm shumën e kërkuar nga ana e palës paditëse më konkretisht shumën prej 1.20 euro, dhe atë duke u bazuar në neni 2.1 të LPK-së, ku përcaktohet se *“në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*.

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka qenë 421.20, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 171.80 euro ( $421.20 \times 3.4\% = 14.30 \times 12 \text{ muaj} = 171.85$ )

- Për paditësen M.B.

Për periudhën 01.04.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2019 ka qenë 421.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 90,93 euro ( $421.20 \times 2.7\% = 11.36 \times 8 \text{ muaj} = 90.93$  euro).

Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 421.20, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 1.20 euro ( $421.20 \times 0.2\% = 0.84 \times 12 \text{ muaj} = 10.10$  euro), mirëpo gjykata në rastin konkret aprovoj vetëm shumën e kërkuar nga ana e palës paditëse më konkretisht shumën prej 1.20 euro, dhe atë duke u bazuar në neni 2.1 të LPK-së, ku përcaktohet se *“në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*.

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka qenë 421.20, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të

futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 171.80 euro ( $421.20 \times 3.4\% = 14.30 \times 12$  muaj = 171.85)

- Për paditësen A.M.

Për periudhën 01.04.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2019 ka qenë 421.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 90,93 euro ( $421.20 \times 2.7\% = 11.36 \times 8$  muaj = 90.93 euro).

Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 421.20, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 0.96 euro ( $421.20 \times 0.2\% = 0.84 \times 12$  muaj = 10.10 euro ) mirëpo gjykata në rastin konkret aprovoj vetëm shumën e kërkuar nga ana e palës paditëse më konkretisht shumën prej 1,08 euro, dhe atë duke u bazuar në neni 2.1 të LPK-së, ku përcaktohet se “në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”.

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka qenë 421.20, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 171.80 euro ( $421.20 \times 3.4\% = 14.30 \times 12$  muaj = 171.85)

- Për paditësen E.S.

Për periudhën 01.04.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2019 ka qenë 421.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 90,93 euro ( $421.20 \times 2.7\% = 11.36 \times 8$  muaj = 90.93 euro).

Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 421.20, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 0.96 euro ( $421.20 \times 0.2\% = 0.84 \times 12$  muaj = 10.10 euro ), mirëpo gjykata në rastin konkret aprovoj vetëm shumën e kërkuar nga ana e palës paditëse më konkretisht shumën prej 0.96 euro, dhe atë duke u bazuar në neni 2.1 të LPK-së, ku përcaktohet se “në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”.

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka qenë 421.20, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 171.80 euro ( $421.20 \times 3.4\% = 14.30 \times 12 \text{ muaj} = 171.85$ )

- Për paditësen A.Ç. 2019

Për periudhën 01.04.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2019 ka qenë 421.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 14.32 euro ( $421.20 \times 2.7\% = 11.36 \times 8 \text{ muaj} = 90.93$  euro).

Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 421.20, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 0.96 euro ( $421.20 \times 0.2\% = 0.84 \times 12 \text{ muaj} = 10.10$  euro), mirëpo gjykata në rastin konkret aprovoj vetëm shumën e kërkuar nga ana e palës paditëse më konkretisht shumën prej 0.96 euro, dhe atë duke u bazuar në neni 2.1 të LPK-së, ku përcaktohet se *“në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*.

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka qenë 421.20, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 171.80 euro ( $421.20 \times 3.4\% = 14.30 \times 12 \text{ muaj} = 171.85$ )

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së



shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 04.05.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 17.04.2017 deri më datë 14.06.2019.

Me paraqitjen e padisë në gjykatë më datë 04.05.2022, në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.06.2019 e deri më 14.06.2022. Edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 04.05.2022, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin prill 2019, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditëses për muajin prill 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që paditësit kanë pranuar pagën e këtij muaji, e cila realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht të njëjtit pas pranimit të kësaj page janë njoftuar se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin prill 2019 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht maj\ 2019, të njëjtit kanë mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që “*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*”. Andaj, mbi këtë bazë, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesat e paditësve sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë sa i përket parashkrimit të kërkesës nga data 17.04.2017 deri më 30 prill 2019.

Gjithashtu, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditësve kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë të cilën e realizojn paditëset A.M., E.S., dhe A.Ç., dhe atë në shumën prej 421.20 euro, si dhe për paditësen M.B. e cila pagën bazë e realizon në shumën prej 421.20 euro duke u bazuar në kontratat e punës dhe vërtetimet e lëshura nga drejtori i shkollës ku janë në marrëdhënie pune paditësit, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditësve, e që është shuma prej 421.00 euro dhe jo siç është kërkuar nga ana e paditësve në shumën prej 522.06 euro dhe për paditësin V.T. pagën bazë e realizon në shumën prej 421.20 euro duke u bazuar në kontratat e punës dhe vërtetimet e lëshura nga drejtori i shkollës ku janë në marrëdhënie pune paditësit, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditësve, e që është shuma prej 421.00 euro dhe jo siç është kërkuar nga ana e paditësve në shumën prej 509.43 euro

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (17.05.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 332 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.1491/2022, datë 21.10.2024

G j y q t a r i  
Shyqri Hoxha

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.